



DEKLARATË E PËRBASHKËT

IDETË TË KTHEHEN NË VEPRIM: TË INVESTOHET TE SHKENCËTARËT E RINJ DHE TE VENDET E PUNËS PËR RITJE

KONFERENCA III E PËRBASHKËT SHKENCORE
PROCESI I BALLKANIT PERËNDIMOR / PROCESI I BERLINIT
Paris · Francë · 14 – 16 qershor 2017

Konferenca III e Përbashkët Shkencore e Procesit të Ballkanit Perëndimor / Procesit të Berlinit u mbledh në akademinë franceze “Académie des sciences – Institut de France” në Paris për ta çuar më tej procesin e nisur në Gjermani në korrik 2015 dhe të vijuar në Austri në maj 2016. Rezultatet e Konferencës I dhe II të Përbashkët Shkencore janë përmbledhur në deklarata të përbashkëta, të cilat kanë marrë mbështetjen e krerëve të shteteve dhe qeverive në Samitet e Ballkanit Perëndimor në Vjenë (2015) dhe Paris (2016)¹.

Konferenca III e Përbashkët Shkencore u fokusua në dy tema kryesore:

1. **Investimi te shkencëtarët e rinj dhe**
2. **Arsimi dhe inovacioni për vende pune dhe rritje.**

Palët e mirëpresin njoftimin e bërë nga academia italiane “Accademia Nazionale dei Lincei” për ta zhvilluar konferencën e ardhshme të përbashkët shkencore të Procesit të Ballkanit Perëndimor në 2018.

Rekomandimet më kryesore

1. Të ngrihet një **Fondacion Kërkimor i Ballkanit Perëndimor** si organizatë vetëqeverisëse ndërkombëtare, i cili t’u japë grante individuale (*ad personam*) shkencëtarëve të rinj për të ngritur ekipe dhe laboratorë kërkimorë në Ballkan dhe i cili të mbështesë lëvizshmërinë dhe ndërlidhjen me homologët europianë.
2. Të përgatitet një **Plan Veprimi i Ballkanit Perëndimor për Rritje të Zgjuar (Smart Growth)** me rekomandime për ta optimizuar lidhjen midis arsimit, kërkimit dhe inovacionit, nga njëra anë, dhe tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik, nga ana tjetër.

Fondacioni Kërkimor i Ballkanit Perëndimor

Në Samitin e Parisit për Ballkanin Perëndimor, datë 4 korrik 2016, krerët e shteteve dhe qeverive shprehën kërkesën si në vijim për Konferencën e Përbashkët Shkencore të Procesit të Ballkanit Perëndimor: “[...] të propozohen [brenda verës së vitit 2017] mekanizma financimi për kërkues të rinj ekselentë nga Ballkani, për t’u dhënë mundësi të fitojnë përvojë jashtë vendit dhe të krijojnë laboratorët e tyre të ekselencës.”

Më pas, është caktuar një grup ndërkombëtar ekspertësh i cili, nëpërmjet një procesi intensiv, ka përgatitur një plan maket të gjithanshëm për një **Fondacion të ri Kërkimor të Ballkanit Perëndimor** (më poshtë, këtu, i quajtur Fondacioni).

Plani maket është miratuar me bashkëpëlqim në Konferencën III të Përbashkët Shkencore të Procesit të Ballkanit Perëndimor.

Misioni dhe instrumentet

Fondacioni është projektuar t’u japë mundësi **shkencëtarëve të rinj të shquar nga Ballkani dhe nga Europa² të ngrënë ekipe dhe laboratorë kërkimorë të ekselencës në vendet e Ballkanit³ brenda një periudhe pesëvjeçare nëpërmjet granteve *ad personam*, duke gëzuar mbartshmërinë e grantit. Grantet do të mundësojnë një periudhë formimi një deri në dy-vjeçare në organizatat më të mira kërkimore të Europës, për t’i forcuar kështu lidhjet shkencore midis Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Europian.**

1 Shih www.leopoldina.org/en/jsc.

2 Nëse është kuptimplotë, mund të pranohen kërkues e projekte kërkimore aplikuese nga vende të tjera me lidhje me Ballkanin.

3 Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova*, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia. (*Ky emërtim nuk çënon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së “Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës”).

Marrëveshjet e grantit midis Fondacionit, grantmarrësve dhe institucioneve pritëse (në Ballkanin Perëndimor dhe në Bashkimin Europian) do të garantojnë autonominë e operacioneve. Këto grante janë një instrument qendror për **rikthimin e trurit** në Ballkan.

Si instrumente të mëtejshme për **qarkullimin e trurit dhe transferimin e njohurive dhe ekselencës**, tri veprime fakultative shtesë do të mbështesin:

- ngritjen e rrjeteve kërkimore brenda Ballkanit,
- punën afruese për njohjen e shoqërisë me gjetjet shkencore dhe
- transferimin e inovacionit dhe teknologjisë në ekonomi dhe në shoqëri.

Realizuesit e ndryshimit

Nëpërmjet granteve të Fondacionit, do të marrë trajtë në formë progresive një masë kritike ekipesh të kërkuesve ekselentë në Ballkan. **Këto ekipe do të përbëjnë forcën shtytëse të ndryshimit:** përmes pjesëmarrjes në këto “koshere” të përqendrimit të dijeve dhe ekselencës, sistemet kombëtare të arsimit dhe shkencës do të përfitojnë nga përmirësimi i qëndrueshëm, duke ndihmuar me përpjekjet e tyre për të qëndruar në shinat europiane apo për ta vendosur kursin e lëvizjes së tyre në atë drejtim. Shkenca sot nuk njih ndarje kombëtare dhe kërkon ngritje të rrjeteve ndërkufitare.

Në konkurrencën globale për mendjet më të mëdha, Fondacioni duhet **të tërhiqte më të mirët e më të mirëve**, duke u kushtuar vëmendje të veçantë shkencëtarëve të rinj nga Ballkani. Pjesëmarrja është e hapur për të gjitha fushat shkencore. Kriteret janë të përcaktuara qartë: shkencëtarët e rinj (maksimumi 45 vjeç), diplomë doktorature në dorë dhe tezë doktorature e publikuar. Cilësia e kërkuesve dhe projekteve kërkimore aplikuese vlerësohet në një proces me dy faza, me intervistë përfundimtare.

Qeverisja dhe organizimi i Fondacionit

Fondacioni do të ngrihet si një institucion vetëqeverisës ndërkombëtar. Italia është e gatshme ta strehojë Fondacionin në Trieste. Fondacioni do të mbahet nga vendet e përfshira në Procesin e Ballkanit Perëndimor; në një fazë të mëpasshme, mund të bashkohen në të edhe vende të tjera të interesuara, si Zvicra apo Norvegjia. Një kontribut financiar nga Komisioni Europian dhe një marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin Europian për Kërkimin Shkencor si edhe bashkëpunimi i mëtejshëm me donatorët publikë dhe privatë janë tejet të dëshirueshëm dhe të pritshëm.

Administrimi i Fondacionit dhe rutina e tij operative do të **ndjekin rreptësisht standardet ndërkombëtare** për të garantuar besueshmërinë dhe reputacionin. Administrata do të jetë sa më e pakët në numër dhe efikase. Rekrutimi i Këshillit Shkencor dhe i personelit administrativ duhet të bëhet vetëm në përputhje me kriteret e cilësisë dhe të publikohet në nivel ndërkombëtar. Në qendër të punës së Fondacionit do të jetë ecuria dhe performanca e grantmarrësve dhe e punës së tyre kërkimore.

SHËNIME

EJL = Europa Juglindore
KE = Komisioni Europian
NVM = ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
STEM = Science, technology, engineering and mathematics

Termi “shkencë” (dhe shprehjet e lidhura me të) kanë të bëjnë me spektrin e plotë të degëve shkencore: shkencat e natyrës, shkencat sociale dhe humane, shkencat formale, shkencat e jetës, shkencat e aplikuarra etj.

Arsimi dhe inovacioni për vende pune dhe rritje

Në deklaratat e mëparshme të përbashkëta të Konferencave të Përbashkëta Shkencore të Procesit të Ballkanit Perëndimor dhe deklaratat përfundimtare të Samiteve të Ballkanit Perëndimor në Paris (2016) dhe Vjenë (2015) theksohej **roli qendror i arsimit, punës kërkimore dhe transferimit të dijeve për krijimin e vendeve të punës si edhe për kohezionin shoqëroro-ekonomik dhe territorial.**

Ballkanin Perëndimor e prekin disa probleme, si varfëria, papunësia (e të rinjve), produktiviteti i ulët i krahut të punës, shfrytëzimi nën nivel i potencialit inovator dhe largimi i trurit dhe emigrimi. Këto probleme kërkojnë një qasje të integruar në nivele të ndryshme: në nivel të Bashkimit Europian, nivel makrorajonal, nivel qendror dhe vendor. Pra, Konferenca e Përbashkët Shkencore e PBP-së do të ngrejë:

Një Grup Ekspertësh për shtjellimin e një “Plani Veprimi të Ballkanit Perëndimor për Rritje të Zgjuar”

Plani i Veprimit synon të japë **rekomandime për të ndërlidhur arsimin, kërkimin dhe inovacionin me tregun e punës dhe zhvillimin.** Në këtë ndërmarrje nxiten të angazhohen aktorët përkatës nga bota akademike, biznesi dhe shoqëria civile, si edhe institucionet financiare ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare për zhvillim. Ajo përbëhet nga tri faza:

- vlerësimi i strategjive dhe nismave ekzistuese,
- identifikimi i fushave problematike dhe
- shtjellimi i rekomandimeve që duhen zbatuar deri në 2020 – 2030.

Grupi i Ekspertëve do të trajtojë modulet tematike të mëposhtme, duke shtjelluar konceptet e paraqitura më poshtë dhe duke analizuar realizueshmërinë e tyre për Ballkanin:

1. Bashkëpunimi universitet-biznes


Platformat universitet-biznes bashkojnë institucionet e arsimit të lartë me sistemin ekonomik, me pjesëmarrjen e autoriteteve vendore dhe qendrore. Duke pasur parasysh madhësinë ekonomike të Ballkanit Perëndimor dhe nevojën për të arritur efektet e ekonomisë së shkallës, këshillohet përqendrimi në platforma të vetme kombëtare dhe në një platformë rajonale. Platforma të tilla do të duhej të mbledheshin një herë në vit, me punë të fuqishme afruese me publikun.

Relevanca e programeve studimore do të duhej të përmirësohej nëpërmjet një bashkëpunimi më të madh midis institucioneve të arsimit të lartë dhe punëdhënësve në hartimin dhe modernizimin e programeve mësimore (përfshirë edhe mësimin e kombinuar), në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe përmes negociimit të mundësive për të fituar përvojë në punë dhe për stazh në shoqëri shtetërore dhe private (përfshirë NVM). **Në këtë proces, do të duhej të garantohej autonomia e universiteteve.**

2. Ekosistemet e inovacionit

Programet mbështetëse, mundësisht të lidhura me parqet e shkencës, biznesit dhe teknologjisë, mund të çojnë në lulëzim të ekosistemeve të inovacionit, duke e rritur kështu ecurinë e inovacionit. Krahas **mbështetjes së lidhshmërisë së profesionistëve më të mirë / performuesve më të mirë**, kjo mund të jetë edhe një motor i konvergencës. Ekzistojnë tashmë instrumente të cilat mund

FONDACIONI KËRKIMOR I BALLKANIT PERËNDIMOR




1 Grante

- ↳ Ngritja e laboratorit ose ekipit të përqendrimit të dijeve / ekselencës, si kërkues parësor (grant individual – ad personam)
- ↳ Punë kërkimore **5-vjeçare** e orientuar nga hulumtimi dhe investigimi
- ↳ Trajnim **1-2-vjeçar** fakultativ paraprak në BE
- ↳ Shuma e grantit = 750.000 EUR

ORGANIZIMI

- ↳ Statusi i një organizate vetëqeverisëse ndërkombëtare
- ↳ Mbajtur nga 13 vendet e Procesit të Ballkanit Perëndimor me mbështetjen e Bashkimit Evropian
- ↳ Mund të vendoset në Trieste, Itali

INSTRUMENTET E FINANCIMIT



2 Elemente të shtuara

- ↳ 3 veprime fakultative si shtesë ndaj granteve për Tesla dhe Çabej
- ↳ Shuma për grant ≥ 12.500 EUR

Këshill Drejtues

Këshill Shkencor + të dërguar të shteteve (1/shtet & KE) + donatorë të tjerë ose subjekte të besuara (fakultative) + Kolegji i Audituesve

Këshilli shkencor ka >50% të vendeve Mblidhet të paktën 1 herë në vit

Bashkëkryetar: Kryetari i Fondacionit + 1 i dërguar shteti

Këshilli: Kryetari i Fondacionit + Nënkryetari + Drejtori i Përgjithshëm + 1 i dërguar shteti Mblidhet rregullisht

Këshilli Shkencor

Vlerësues / Panel (≥ 19) 3-4 nënpanele sipas disiplinave madhore

Vlerëson kërkesat (proces me dy faza me intervistë përfundimtare) Mblidhet sipas nevojës

Kryetari: Kryetari i Fondacionit + Nënkryetari (të paktën një grua)

Agjencia Ekzekutive

Grantmarrësit

Marrëveshje granti midis fondacionit, grantmarrësit dhe institucionit pritës (qasja e përshtatur)

Skema e Asistencës me Grante (individuale, fleksibël)

Vlerësim & monitorim i granteve (në vazhdimësi)

të kopjohen për t'iu përshtatur kushteve të Ballkanit Perëndimor, për shembull:

- Komuniteti Rajonal i Inovatorëve në Ballkanin Perëndimor;
- Strategji e Specializimit Inteligjent me mbështetjen e KE-së⁴;
- Konkurse kombëtare të novacionit dhe biznese të reja⁵;
- Përdorimi strategjik i parqeve të shkencës dhe teknologjisë dhe i partneriteteve publike-private në fushën e kërkim-zhvillimit.

3. Partneritetet strategjike

Për menaxhimin e reformave “të mëdha” strukturore – siç janë modellet e reja të financimit në bazë të performancës apo ristrukturimi i universiteteve – mund të përdoret **partneritete për modernizim midis ministrive të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të shteteve anëtare të BE-së**. Këto do të fokusoheshin te projektimi i përbashkët i reformave dhe strategjive, si edhe te vënja në zbatim e tyre.

Si pasqyrim i partneriteteve ministrore, universitetet dhe konferencat e rektorëve mund të bashkëpunojnë me homologët e tyre në BE në procesin e tranzicionit institucional, sigurimit të cilësisë, futjes së plotë në zbatim të sistemit të Bolonjës etj. Në këtë drejtim, **përdorimi i projekteve pilot** do të ishte një qasje e përshtatshme.

4. Diploma të përbashkëta dhe lëvizshmëria

Për t'iu maksimizuar mundësitë e Procesit të Bolonjës, universitetet mund të angazhohen në **programe për diploma të përbashkëta me universitete partnere⁶ dhe me sektorët e ekonomisë / biznesin** dhe kështu ta bëjnë lëvizshmërinë akademike mjet për rritjen e performancës. Gjithashtu, shoqatat e ish-studentëve dhe shoqatat profesionale janë të dobishme për ngritjen e rrjeteve strategjike. Është mirë të zhvillohen formatet e mëposhtme:

- Diploma të përbashkëta, si klasike, ashtu edhe inovatore, midis universiteteve në Ballkanin Perëndimor, në Europën Juglindore dhe në Bashkimin Europian;
- Diploma të përbashkëta midis universitetit dhe industrisë, me formim shtesë për shprehje ndërvepruese dhe të iniciativës private;
- Skema të lëvizshmërisë si Erasmus+ brenda Ballkanit Perëndimor, duke garantuar transferueshmërinë e plotë të krediteve;
- Formimi i grupeve “elitare” të të diplomuarve në fusha të përzgjedhura strategjike – për shembull, nëpunës civilë, inxhinierë, menaxherë shkencorë, gazetarë etj. – nëpërmjet diplomave të përbashkëta me universitete të njohura të BE-së.

5. Akreditimi dhe sigurimi i cilësisë

Kur nuk është bërë, është mirë të bëhet akreditimi i universiteteve dhe programeve studimore dhe të zbatohet **masa rigorozë të sigurimit të cilësisë** për ta rritur cilësinë e shërbimeve të arsimit të lartë. Vlerësimi i jashtëm i institucioneve të arsimit të lartë duhet të kryhet në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë.

4 Shih s3platform.jrc.ec.europa.eu.

5 E ngjashme me programin francez “Investissements d’avenir” ose programin gjerman “Deutschland – Land der Ideen”.

6 Një kuadër i përshtatshëm është “Platforma Rajonale Ndëruniversitare për Vlerësimin e Krahasuar dhe Bashkëpunimin në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Ballkanin Perëndimor” – ngritur nga universitetet kryesore rajonale dhe ministrinë.

5 KORRIK 2017

DEKLARATË E PËRBASHKËT E KONFERENCËS III SHKENCORE TË PROCESIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR / PROCESIT TË BERLINIT

6. Mundësi më e madhe punësimi për të diplomuarit

Universitetet dhe shërbimet publike **të punësimit do të duhej të përmirësonin shërbimet mbështetëse dhe këshillimore për ata të diplomuar që janë në kërkim të një vendi pune** për të siguruar që të rritet numri i të diplomuarve që punojnë në vende pune të përputhura mirë me ta. Kjo kërkohet në mënyrë që të zvogëlohen rrjetet informale dhe nepotizmi në tregun e punës. Është mirë të mendohet edhe për **programe vendore / kombëtare të orientimit profesional**, të cilat do të përfshinin arsim profesional të dyfishtë, formim profesional, arsimim të vazhdueshëm dhe rikualifikim.

Universitetet t’u japin më shumë informacion nxënësve të shkollave të mesme që mund të regjistrohen në to, lidhur me kërkesën në tregun e punës. Edhe qeveritë t’i përdorin bursat dhe kuotat në buxhet (nëse ka) **për t’i bërë më tërheqëse degët prioritare si shkencat ekzakte dhe sektorët me rritje të shpejtë (për shembull, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit)**.

PALËT PJSËMARRËSE

AKADEMITË KOMBËTARE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Muzafer Korkuti) | Akademia Austriake e Shkencave (Anton Zeilinger) | Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Bosnje-Hercegovinës (Miloš Trifković) | Akademia Franceze e Shkencave (Sébastien Candel) | Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave “Leopoldina” (Jörg Hacker) | Akademia Italiane “dei Lincei” (Mario Stefanini) | Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Nexhat Daci) | Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve (Taki Fiti) | Akademia Malazeze e Shkencave dhe e Arteve (Dragan K. Vukčević) | Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve (Ljubomir Maksimović) | Akademia Sllovene e Shkencave dhe e Arteve (Tadej Bajd) | Shoqëria Mbretërore Britanike (James Jackson)

KONFERENCAT KOMBËTARE TË REKTORËVE DHE UNIVERSITETET

Konferenca e Rektorëve e Republikës së Shqipërisë (Valentina Duka) | Konferenca Austriake e Universiteteve uniko (Elisabeth Freismuth) | Universiteti i Sarajevës (Rifat Škrijelj) | Universiteti i Banja Llukës (Milan Mataruga) | Konferenca e Rektorëve e Republikës së Kroacisë (Marin Milković) | Konferenca e Dekanëve e Fakulteteve Franceze të Inxhinierisë (Pierre Koch) | Konferenca e Kryetarëve të Universiteteve të Francës (Jacques Comby) | Konferenca Gjermane e Rektorëve (Horst Hippler) | Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (Marjan Dema) | Universiteti i Shkupit “Shenjtoret Kiril dhe Metod” (Nikola Jankulovski) | Universiteti i Evropës Juglindore i Tetovës (Zamir Dika) | Universiteti i Malit të Zi (Radmila Vojvodić) | Konferenca e Universiteteve Serbe (Vladimir Bumbaširević) | Universiteti i Novi Sadit (Dušan Nikolić) | Konferenca e Rektorëve e Republikës së Sllovenisë (Boris Kavur)

SHKENCËTARË TË NJOHUR DHE EKSPERTË JO PËRFAQËSUES

Boban Arsenijević (Universiteti i Nishit) | Blerjana Bino (Universiteti European i Tiranës dhe Universiteti i Upsalës) | Donald Bruce Dingwell (Universiteti “Ludwig Maximilian” Mynih) | Dhimitër Doka (Universiteti i Tiranës) | Arjan Gjonça (Shkolla Londineze e Ekonomisë dhe Shkencave Politike) | Zoran Hadzi-Velkov (Universiteti “Shenjtoret Kiril dhe Metod” i Shkupit) | Armanda K. Hysa (Qendra e Studime Albanologjike, Tiranë) | Marija Jankovic (CentraleSupélec, Universiteti i Paris-Saclay) | Stipan Jonjić (Universiteti i Rijekës) | Erna Karalija (Universiteti i Sarajevës) | Almir Maljević (Universiteti i Sarajevës) | Fetah Podvorica (Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”) | Miroslav Radman (Instituti Mesdhetar për Shkencat e Jetës, Split dhe Universiteti “Descartes” Paris) | Oliver Jens Schmitt (Universiteti i Vjenës) | Sofija Stefanović (Universiteti i Beogradit dhe Instituti “BioSense”, Universiteti i Novi Sadit)

FOLËS TË FTUAR

William Bartlett (Shkolla Londineze e Ekonomisë dhe Shkencave Politike) | Jean-Paul Chabard (“Électricité de France EDF S.A.”) | Martin Dietz (“Helvetas Swiss Intercooperation – PERFORM”) | Adnan Ibrahimbegović (Universiteti i Teknologjisë i Compiègne) | Didier Roux (“Saint-Gobain S.A.”) dhe Akademia Franceze e Shkencave) | Ivan Svetlik (Universiteti i Lubjanës)